



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 162, Datë 15.08.2024

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “FURNIZUESI I SHËRBIMIT
UNIVERSAL” SH.A. NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 13, si dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.08.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1318/5 prot., datë 05.08.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” (FSHU) sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1318/1 prot., datë 19.06.2024, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 142, datë 16.07.2024, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 427, Seria F18, të shoqërisë “FSHU” sh.a, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, rinovuar sërish me vendimin nr. 164, datë 04.11.2019.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 17.07.2024 dhe 18.07.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 26.07.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u publikua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1318/3 prot., datë 19.07.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin për fillimin e procedurës dhe kërkesën për plotësimin e dokumentacionit për të vijuar me procedurën për rinovim licence.
- Në vijim, shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1318/4 prot., datë 29.07.2024 ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën nr. 427, Seria F18, të shoqërisë “FSHU” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, rinovuar sërish me vendimin nr. 164, datë 04.11.2019, për një afat 5-vjeçar duke filluar nga data 22.12.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI